



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:095524

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644535

KPPP.nr.682/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.B “Ballabani Komerc” me NUI: 80047134, me seli në Rr. “Agim Ramadani” nr.22/96 në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florian Petani, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.195/22 të datës 08.04.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.B “Ballabani Komerc”, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.195/22 i datës 08.04.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.195/22 të datës 08.04.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.2022/0857 të datës 10.03.2022 dhe Kartelës Financiare të datës 29.03.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t’ia paguaj kreditorit shumën prej 12,876.90 €, për periudhën 01.01.2019 deri më 01.03.2022, me kamatë ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga dita e dorëzimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e

përmbartimit sipas tarifës së Përmbartuesit Privat, me kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, përmes bllokimit të llogarive bankare, regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e kredisë së kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar se dokumenti në bazë të cilës është marrë urdhri përmbartues nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, për shkak se kartela financiare e paraqitur nga kreditori nuk mund të cilësohet si ekstrakt i verifikuar nga librat afarist. Më tutje ka deklaruar se fatura e lartcekur ka të bëjë me faturimin e qirasë për një lokacion tjetër, si dhe kjo kërkesë e qirasë është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara me arsyetimin se ka vepruar konform rregullave ligjore me rastin e paraqitjes së Urdhrit Përmbartimor duke i respektuar të gjitha procedurat dhe duke i bashkëngjitur Faturën Kthyesë Nr. 2022/0857 të datës 01.03.2022 dhe Kartelën Financiare të datës 29.03.2022 si dokumente të besueshme të cilat e kanë fuqinë e titullit përmbartues. Ka shtuar se debitori me pagesën në shumën prej 400.00 € e cila evidentohet nga dëftesëpagesa e datës 16.03.2022, ka ndërprerë parashkrimin konform dispozitave të nenit 368 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbartimit P.nr.195/22 i datës 08.04.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin KPPP.nr.522/23 të datës 07.07.2023, e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.195/22 të datës 08.04.2022, si dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr.1561/2023 të datës 12.04.2024 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka prishur aktvendimin KPPP.nr.522/23 të datës 07.07.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe e ka kthyer lëndën në rivendosje dhe rigjykim.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 2022/0857 e datës 10.03.2022 dhe Kartela Financiare e datës 29.03.2022 në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“1. Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokumenti i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura Nr. 2022/0857 e datës 10.03.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nga kjo faturë nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, për cilat shërbime është lëshuar e njëjta, sepse në faturë është përshkruar vlera e faturës pas tatimit mbi qiranë 9%, për një muaj, në shumën prej 565.45 € dhe 395.45 €, ndërsa borxhi total i kërkuar sipas faturës është në shumën prej 12,876.90 €, andaj shërbimi i përshkruar në këtë faturë nuk përputhet me borxhin total i cili kërkohet sipas të njëjtës.

Meqenëse fatura nuk e përmban objektin e detyrimit siç përcaktohet sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbaarueshmërisë.

Po ashtu gjykata vlerëson se dokumentet e bashkëngjitura në këtë propozim, përkatësisht Kartela Financiare e datës 29.03.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 të LPP-së, nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm.

Bazuar në dispozitën e lartcekur, është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbaarim është lejuar sipas një dokumenti - kartelës financiare në kuadër të Ndërmarrjes Publike Banesore, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaarim, e mbi bazën e të cilit përmbaaruesi privat ka lejuar përmbaarimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata morri parasysh edhe sugjerimet e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Dytë, të dhëna sipas Aktvendimit K.Dh.Sh.K.II.nr 1561/23 të datës 12.04.2024, me anë të së cilës është vlerësuar se Kartela Financiare e datës 29.03.2022 është dokument publik dhe se i njëjti përbën dokument përmbaarues dhe është i përshtatshëm për përmbaarim, konform nenit 29 par.1 pika 1.4 të LPP-së, mirëpo gjeti se në rastin konkret kartela financiare e kreditorit nuk përbën dokument publik sipas përkufizimeve të përcaktuara në Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Sipas nenit 3 par.1 në par 1.2 të Ligjit nr. nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Dokument Publik: *“nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik”*.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe duke marr parasysh faktin që kreditori nuk e ka cilësinë e një institucioni publik si dhe faktin që kartela financiare e kreditorit nuk përbën

dokument publik, rezulton se dispozita e nenit 29 par. 1 pika 1.4 e LPP-së, nuk mund të aplikohet në këtë rast dhe se kjo kartelë nuk mund të shërbej për qëllime të përmbarimit.

Gjykata nuk e trajtoi fare pretendimin e debitorit, sa i përket parashkrimit të kërkesës, pasi që dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin rezulton se nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, andaj nga këto arsye edhe urdhrin e lejuar nga ana e përmbaruesit privat e ka anuluar dhe e ka përfunduar në tërësi procedurën përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.682/24, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.